

STATUT
i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar
“Altus Construction” sh.p.k.

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më 30/01/2025 une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **Altus Construction sh.p.k**
- (2) Themelues dhe ortak i vetëm i shoqërisë është:
- Ervis Cemi

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Ne fushen e ndertimit, punime e germime ne toke, ndertime civile e industriale, veshje fasadash, rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile, industriale, ndertim rruge autostrada, mbikalime hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, punime nentokesore ura e vepra arti, ndertime ujesjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, ndertime detare dhe punime thellimi ne uje, punime dhe sisteme hidraulike dhe elektrike, punime te inxhinjerise mjedisit, punime per prishjen e ndertimeve, impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndricuese, barrier dhe mbrojtje rrugore, strukture metalike, punime mbi shina e traversa, impiante te ndryshme elektrike. Ne fushen e transportit te mallrave dhe udhetareve, brenda dhe jashte vendit, ne fushen e tregtise me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore, industrial, te automjeteve e tregti te tjera te lejuara nga ligji. Tregtimi i karburanteve te ndryshme, gazit te lengeshem. Shoqeria mund te kryeje edhe cdo lloje aktiviteti tjeter qe nuk eshte i ndaluar nga ligji shqiptar dhe qe ka lidhje te mjaftueshme me objektin e aktivitetit te sajë

Financim, projektim, ndertim, venie ne pune, shfrytezim, mirembajtje, administrim. Prodhim, furnizim, transmetim, instalim te prodhimit te energjise dhe veprave hidroenergjitike, shperndarja, importi dhe eksporti, shitja e energjise elektrike te prodhuar. Kryerja e cdo aktiviteti qe i sherben realizimit te veprimtarise se shoqerise ne fushen e energjise. Transport mbetjesh jo te rrezikshme. Stacion transferimi mbetjesh jo te rrezikshme. Per tregtim te paisjeve spitalore dhe cdo aktivitet tjeter qe i sherben realizimit te kesaj veprimtarie. Ndertime per N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Import-eksport materialeve elektrike, hidraulike tregtimin e tyre me pakice dhe shumice.

Zhvillimi i pasurive te paluajtshme, te zoteroje dhe menaxhoje pasuri te paluajtshme e te luajtshme si dhe gjithë te drejtat e tjera shtese qe lidhen me keto pasuri

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4:

Selia

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Nacionale Prrenjas, numri i pasurisë 844/50.
- (2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

Kreu II Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtëm:

— Ortaku themelues Ervis Cemi: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të Përgjithshme 1,000 leke që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Në rastin kur Shoqëria zotërohet vetëm nga 1 (një) ortak, të gjithë vendimet merren nga ai, pa qene e nevojshme thirrja dhe mbledhja e Asamblese së ortakëve. Përkundrazi do të bëhet vetëm në ato raste kur ligji parashikon të detyrueshme thirrjen e mbledhjes së Asamblese dhe marrjen e vendimeve.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) ndryshimet e statutit;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë për një afat prej 5 (pesë) vitesh, personi si më poshtë.

- Ervis Cemi, shtetas shqiptar, lindur në Shkodër, në 01.08.1979, identifikuar me letërnjoftimin shqiptar me nr.personal H90801157M

Neni 13

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të theksin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15 Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në

përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";

e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 17

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 19 Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Altus Construction sh.p.k.

ERVIS CEMI

